

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**Forca Tokësore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar / Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Punëtor mirëmbajtjeje i profesioneve të ndryshme	Rep. usht. nr.1050 në FT	Zall-Herr, Tiranë	E pacaktuar	Me dosje	Nuk aplikohet	16.12.2024	30.12.2024

Formulari nr.1

1. Pozicioni i punës:	“Punëtor mirëmbajtjeje i profesioneve të ndryshme” , në grupin e mbështetjes, në Repartin Ushtarak nr.1050, në ROS, në Forcën Tokësore, me kod vendndodhje A-045, kod grupi E, numër paragrafi 01, numër rendor 10 dhe specialitet LI 2390.
2. Kodi i pozicionit:	C2, (Civil II).
3. Reparti/Institucioni:	Reparti ushtarak nr.1050, Zall-Herr, në Forcën Tokësore.
4. Vendi:	Zall-Herr, Tiranë
5. Paga:	VKM nr.234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar.
7. Data e fillimit të aplikimit:	16.12.2024
8. Data e mbylljes së aplikimit:	30.12.2024
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	- Kërkesë. - Formularin e aplikimit. - Fotokopje të kartës së identitetit. - Diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare, diplomën e shkollës së lartë të noterizuar ose në original. - Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit. - Dëshmi profesioni nëse ka. - Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja. - Raport mjeksor. - Fotografi me përmasa 4x6, 2-copë. - Dëshmi penaliteti. - Vërtetim nga gjykata. - Vërtetim nga Prokuroria. - Librezë pune. - Jetëshkrimin CV. - Formularin e vetëdeklarimit.

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- Të ketë shtetësinë shqiptare.
- Të jetë jo më pak se 18-vjeç.
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara.
- Të jetë i aftë për punë nga ana shëndetsore.
- Të mos jetë dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi.
- Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda një viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil II.
- b. Arsimi: Të ketë kryer arsimin e mesëm.
- c. Kualifikimi: Të ketë përvojë pune dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kritereve të miratuara.
- d. Trajnimi: Nuk është e aplikueshme.
- e. Eksperienca në punë: Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- f. Gjuha e huaj: e pa aplikueshme
- g. Kërkesa të tjera specifike:
 - Të ketë eksperiencë sidomos si luleshtar.
 - Të ketë eksperiencë të mëparshme.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: e pa aplikueshme.

13. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore: : “Punëtor mirëmbajtje i profesioneve të ndryshme”, në grupin e mbështetjes, në Repartin Ushtarak nr.1050, në ROS, në Forcën Tokësore, me kod vendndodhje A-045, kod grupi E, numër paragrafi 01, numër rendor 10 dhe specialitet LI 2390; kryen këto detyra dhe mban përgjegjësi:

- Ka vartësi direkt nga komandanti i skuadrës së shërbimeve.
- Të njohë rregullat, urdhërat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve në funksion të mirëmbajtjes dhe gjelbërimit të ambjenteve.
- Përgjigjet për pastërtinë e ambjenteve në territorin e repartit.
- Pastron çdo ditë ambientet e përbashkëta si nyje hidrosanitare, korridore, shkallë dhe pjesë të veçanta të territorit .
- Kryen detyrën si luleshtar dhe për mirëmbajtjen e gjelbërimit
- Mirëmban pajisjet e punës.
- Për çdo konstatim të dëmtimit të pajisjeve apo ambjenteve të punës i raporton komandantit përkatës.
- Çdo ditë me mbarimin e punës kontrollon mbylljen e dyerve, dritareve të çelësave elektrik, mbylljen e rubinetave të çezmave etj.
- Pastrimin e zyrave e bënë në orarin e punës dhe në prezencë të përgjegjësit të zyrës.
- Të njoh dhe zbatoj rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga zjarri në vendin e punës.
- Kryen detyra të tjera të caktuara nga eprori.

Përgjegjësitë: ndjek dhe zbaton detyrat e ngarkuara nga Komandanti i repartit ushtarak nr. 1050.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3-(tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- Përzgjedhjen paraprake.
- Vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Tokësore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Komisioni, me mbylljen e aplikimeve, verifikon dokumentacionin e aplikantëve nëse ai është i plotë dhe i saktë si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Kandidatët njoftohen nëse janë përzgjedhur ose jo për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- Vlerësimin e dokumentave të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës, të lidhura me fushën përkatëse).

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, kandidatët listohen sipas listë meritës. Pas listimit të 3-tre kandidatëve, i paraqitet autoriteteve kompetente një memo miratuese për përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm.

Me emërimin në pozicionin e punës, do të lidhet kontrata individuale e punës.

SHEFI I DEGËS PERSONELIT

Nënkolonel Xhemil Hurdha